

I ftuar në televizionin francez, filozofi i njohur francez i gjeneratës së re, Michel Onfray, duke komentuar sulmin ndaj redaksisë së revistës "Charlie Hebdo", mes tjerash tha: "Ne përëndimorët shkojmë në vendet muslimane, përzihemi në punët e tyre të brendshme dhe i vrasim ata, qoftë në Afrikë apo Afrikën veriore, e kur muslimanët mbrohen nga okupimi, i akuzojmë për terrorizëm. Muslimanët nuk janë mendjelehtë dhe naivë ashtu siç mendojnë për ta në Francë, Evropë dhe Botë, dhe ajo që ne bëjmë në vendet e tyre është shumë më e keqe se vrasja e 10 njerëzve. Ne çdo ditë vrasim qindra muslimanë në vendet e tyre", transmeton saff.

Ai pastaj shtoi: "Racizmi është problemi ynë. Përse, pas sulmit ndaj "Charlie Hebdo", jemi ngutur të deklarojmë se shkaktari i kësaj vepre është terrorist, e asnjëherë nuk kemi bërë presion ndaj revistës që të ndërpres ofendimet ndaj të Dërguarit Muhamed, e me këtë edhe ndaj muslimanëve, përmes karikaturave të cilat kanë publikuar?"/Shembulli/